

Buletin informativ

Rreth Pronarëve Përfitues

Shkurt 2021



Ju sjellim në vëmendje se çdo person juridik i regjistruar në Regjistrin Tregtar duhet të regjistrojë pronarin/ët përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues (RPP) brenda 60 ditëve nga krijimi i tij, sipas kërkesave të Ligjit nr. 112/2020 (këtu më poshtë referuar si “Ligji”) dhe VKM-së me nr. 1088, datë 24.12.2020.

Kujtojmë që **pronar përfitues** është individ i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër, të:

- aksioneve/kuotave;
- pjesëmarrjes në kapitalin e subjektit tuaj;
- të drejtave të votimit; ose
- përfiton nga transaksionet e kryera nga subjekti juaj në emër të tij.

Në rast të operimit nëpërmjet **një trusti**, pronar përfitues në kuptim të këtij Ligji është:

- krijuesi;
- kujdestari/i mirëbesuari;
- mbrojtësin, nëse ka;
- përfituesi; kur personat që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose entiteti ende nuk janë përcaktuar, klasa e personave për interesin kryesor të të cilëve marrëveshja ligjore ose entiteti është krijuar ose operon;
- ose çdo individ tjetër që ushtron kontrollin e fundit mbi trustin me anë të pronësisë direkte ose indirekte ose me mjete të tjera.

Buletin informativ

Rreth Pronarëve Përfitues

Në rastin e organizatave **jofitimprurëse** (ku përfshihen fondacionet, shoqatat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse) pronar përfitues në kuptim të këtij Ligji është:

- themeluesi; ose
- përfaqësuesi ligjor; ose
- individ që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse. Kontrolli i fundit efektiv është marrëdhënia në të cilën një person:
 - i. përcakton vendimet e marra nga organizata jofitimprurëse;
 - ii. kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse.

❖ Si kryhet regjistrimi?

Regjistrimi kryhet nëpërmjet shërbimit *“Regjistrimi i pronarit përfitues”* në portalin e-albania, aplikim ky që kryhet nga personi i autorizuar (përfaqësuesi ligjor).

Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti, sipas kërkesave të shfaqura në portal janë:

- Të dhënat identifikuese / personale të përfaqësuesit ligjor;
- Të dhënat identifikuese / personale të pronarëve përfitues;
- Dokumentacioni që vërteton numrin unik të identifikimit, emrin si dhe datën e regjistrimit të subjektit raportues në regjistrin përkatës (ekstrakti);
- Dokumentacioni i autoritetit kompetent regjistruar, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, ose të të drejtave të votimit;
- Dokumentacion tjetër që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues;
- Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, ku të përcaktohen saktësisht hapat e ndërmarra për identifikimin e pronarit përfitues si dhe arsyet e identifikimit të tij në këtë pozicion (rasti kur nuk arrihet të identifikohet individ zotërues i 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit; ose të të drejtave të votimit);
- Dokumentacion që vërteton kontrollin e individit të regjistruar si pronar përfitues, në subjektin raportues (rasti kur nuk arrihet të identifikohet individ zotërues i 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit; ose të të drejtave të votimit);
- Dokumentacion që vërteton pozicionin e individit të regjistruar si pronar përfitues, në subjektin raportues (rasti kur nuk arrihet të identifikohet individ zotërues i 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit; ose të të drejtave të votimit);
- Dokumentacion tjetër shoqërues që vërteton të dhënat e regjistruara;
- Dokumenti i autorizimit, nëse aplikimi nuk kryhet nga përfaqësuesi ligjor.

QKB, shqyrton aplikimin **brenda dy ditë pune**, sipas kërkesave të Ligjit, pas verifikimit të të cilave vendos miratimin ose refuzimin e tij, vendimmarrje e cila publikohet më pas në RPP.



Buletin informativ

Rreth Pronarëve Përfitues

❖ Kundërvajtjet për mospërbushje të dispozitave ligjore

Në rast të mospërbushjes së dispozitave ligjore, Ligji përcakton kundërvajtjet administrative si më poshtë:

- a) mosregjistrimi fillestar i të dhënave për Pronarin Përfitues të tij brenda afatit të përcaktuar të këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën 500 000 lekë;
- b) mosregjistrimi i çdo ndryshimi në të dhënat e regjistruara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, brenda afatit të përcaktuar dënohet me gjobë në vlerën 250 000 lekë;
- c) mospërbushja e detyrimit të subjekteve raportuese ekzistuese për regjistrimin e të dhënave të kërkuara nga ky ligj brenda afatit të përcaktuar dënohet me gjobë në vlerën 250 000 lekë.

Për shkeljet e parashikuara më sipër dënohet me gjobë prej 150 000 lekësh edhe përfaqësuesi ligjor i subjektit të regjistruar.

Për subjektet, që kryejnë shkeljet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, për më tepër se një herë, gjobat do të dyfishohen.

Burimi:

- i. Ligji nr. 112/2020, datë 29.07.2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", Fletore zyrtare nr. 149, Datë. 13/08/2020;
- ii. Vendim nr. 1088, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për Pronarët Përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara”;
- iii. E-albania: https://e-albania.al/ealbaniaservices/useservice.aspx?Service_code=14519



Buletin informativ

Rreth Pronarëve Përfitues

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutemi kontaktoni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889
E-mail: info@mazars.al